



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 19.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **17.06.2025**, të parashtruar nga **global CT Digital Kosovo** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Zhvillimi i Modulit të TMJISHP"** me nr. prokurimi 206-25-4491-1-1-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE global CT Digital Kosovo e dt. 17.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Zhvillimi i Modulit të TMJISHP"** me nr. prokurimi 206-25-4491-1-1-1, kundër Njoftimit për kontratë të datës 22.05.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi për kontratë të datës 22.05.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE global CT Digital Kosovo me datën 17.06.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Zhvillimi i Modulit të TMJISHP"** me nr. prokurimi 206-25-4491-1-1-1. Autoriteti Kontraktues me datë 19.06.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Neni 7 i LPP – Barazia në trajtim / Mosdiskriminimi

Neni 6 i LPP – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 66 i LPP – Përshtatshmëria Profesionale

Neni 69 i LPP – Kapacitetet teknike dhe profesionale

Neni 26.6 i RRUOPP

Pretendimet ankimore te OE ankues:

1. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë që ka favorizuar ose diskriminuar OEtë, duke vendosur një kërkesë të panevojshme dhe disproporcionale në Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale që pengon konkurrencën e barabartë, dhe ka vepruar në shpërputhje me nenin 7.

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë që ka favorizuar ose diskriminuar operatorët ekonomikë, duke përfshirë në dosjen e tenderit një kërkesë për certifikatë ISO 27001 si pjesë e Kërkesave të Përshtatshmërisë Profesionale, duke e bërë këtë kërkesë të detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë ose për të gjithë anëtarët e grupit të operatorëve ekonomikë. Ky veprim është në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së (Barazia në trajtim / mosdiskriminimi).

Argumentet 1: Kjo mënyrë e formulimit të kërkesës krijon trajtim jo të barabartë, pasi:

- Kërkesa për ISO 27001 është formuluar në një mënyrë që vendos një standard të menaxhimit të sigurisë së informacionit si kusht profesional, duke mos marrë parasysh rolin konkret të secilit operator ose anëtar të grupit në realizimin e kontratës.
- Kjo favorizon në mënyrë të pajustificuar operatorët që posedojnë këtë certifikatë, edhe kur standardi ISO 27001 nuk ka lidhje të domosdoshme me të gjithë objektin e kontratës ose të gjitha aktivitetet që mbulohen nga operatorët ekonomikë.
- Vendosja e kësaj kërkesë në këtë formë redukton konkurrencën efektive dhe krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje.

2. AK ka vendosur kërkesa që nuk janë të lidhura në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës, duke cenuar ekonomikitetin e procedurës së prokurimit, sic percktohet me nenin 6 te LPP

Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues ka vendosur një kërkesë për ISO 27001 e cila nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk është e domosdoshme për realizimin e saj, duke cenuar parimin e ekonomikitetit dhe efikasitetit të procedurës së prokurimit, siç përcakton Neni 6 i LPP-së.

Argumentet: Kërkesa për ISO 27001, e vendosur si kusht i përshtatshmërisë profesionale:

- Kërkesa për ISO 27001, e vendosur si kusht i përshtatshmërisë profesionale, nuk sjell asnjë vlerë të shtuar reale për efikasitetin e kontratës dhe realizimin e objektivave të saj.
- Standardi ISO 27001 nuk është i lidhur ngushtë dhe në mënyrë të domosdoshme me të gjitha aktivitetet që përfshin kontrata, prandaj kërkesa bie ndesh me parimin e proporcionalitetit që duhet të udhëheqë çdo kërkesë në procedurë.

3 Autoriteti Kontraktues ka interpretuar gabimisht këtë Nenin 66 të LPP –

Përshtatshmëria Profesionale duke e përdorur si bazë për të kërkuar një certifikatë që nuk lidhet me regjistrimin profesional, licencën apo autorizimin për ushtrim veprimtarie.

Pretendimi 3: Autoriteti Kontraktues ka interpretuar gabimisht Nenin 66 të LPP-së, duke e përdorur si bazë për të kërkuar një certifikatë ISO 27001 që nuk lidhet me regjistrimin profesional, licencën apo autorizimin për ushtrimin e një veprimtarie që lidhet me objektin e kontratës.

Argumentet:

- Sipas Nenit 66 të LPP-së, përshtatshmëria profesionale ka të bëjë me regjistrimin komercial dhe profesional ose me posedimin e licencave dhe autorizimeve të kërkuara nga legjislacioni përkatës për ushtrimin e një veprimtarie specifike.
- ISO 27001 nuk përbën licencë, autorizim apo regjistrim profesional për të ushtruar aktivitetin, por është një standard i vullnetshëm për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit.
- Vendosja e kërkesës për këtë standard në kuadrin e përshtatshmërisë profesionale nuk ka bazë ligjore dhe përbën keqinterpretim të qartë të Nenit 66 të LPP-së.

4. Autoriteti Kontraktues ka dështuar ta vendosë kërkesën për ISO 27001 në kuadrin e duhur ligjor të kapaciteteve teknike dhe profesionale, siç e lejon neni 67 dhe 69 i LPP-së.

Pretendimi 4: Autoriteti Kontraktues ka dështuar të pozicionojë kërkesën për ISO 27001 në kuadrin e duhur ligjor të kapaciteteve teknike dhe profesionale, ashtu siç e përcakton dhe e lejon qartësisht neni 67 dhe 69 i LPP-së.

Argumentet:

- ISO 27001 dëshmon një kapacitet teknik të operatorit ekonomik në menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe nuk përfaqëson një kriter për përshtatshmërinë profesionale në kuptimin e të drejtës për ushtrimin e një veprimtarie (licencë, regjistrim apo autorizim).
- Neni 69 i LPP-së autorizon Autoritetin Kontraktues të kërkojë dëshmi të kapaciteteve teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e kontratës dhe përmbushjen e saj në përputhje me standardet e kërkuara. AK ka dështuar të aplikojë këtë dispozitë dhe ka përzier pa bazë ligjore kriteret teknike me ato të përshtatshmërisë profesionale.
- Ky veprim ka krijuar konfuzion ligjor dhe procedural dhe ka vendosur një barrë të pajustificuar dhe disproporcionale mbi operatorët ekonomikë, duke penguar konkurrencën e ndershme dhe efektive në procedurë.

5. Autoriteti Kontraktues ka keqinterpretuar zbatimin e këtij nenin 26.6 të RRUOPP, duke trajtuar gabimisht ISO 27001 si certifikatë për sigurimin e cilësisë sipas nenit 70 të LPP-së, kurse në të vërtetë ky standard nuk është certifikatë e tillë në kuptimin e kësaj dispozite.

Pretendimi 5: Autoriteti Kontraktues ka keqinterpretuar nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRUOPP) dhe nenin 70 të LPP-së, duke trajtuar gabimisht ISO 27001 si një certifikatë për sigurimin e cilësisë, ndërkohë që ky standard nuk hyn në këtë kategori në kuptimin e këtyre dispozitave.

Argumentet:

- **Neni 26.6 i RRUOPP** dhe praktika e konsoliduar e **OSHP-së** e lidhin sigurimin e cilësisë kryesisht me standarde të tilla si **ISO 9001**, të cilat dëshmojnë për kapacitetet e operatorëve ekonomikë në menaxhimin e cilësisë së shërbimeve ose produkteve.
 - **ISO 27001** është një standard i sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe nuk ka si qëllim ose funksion të dëshmojë cilësinë e shërbimeve ose produkteve që ofron operatori ekonomik.
 - Vendosja e kërkesës për ISO 27001 si certifikatë për sigurimin e cilësisë në kuptimin e nenit 70 të LPP-së përbën **gabim material dhe ligjor**, i cili cenon ligjshmërinë dhe drejtësinë e procedurës së prokurimit dhe krijon kushte të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.
- Ky keqinterpretim i Autoritetit Kontraktues ka ndikuar drejtpërdrejt në cenimin e konkurrencës, ka rritur barrierat të panevojshme për pjesëmarrje dhe ka shkelur parimet themelore të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në prokurim.

Përfundim

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), Rregulloren për Prokurimin Publik (RRUOPP) dhe praktikën e Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe KRPP, është e qartë se mënyra se si Autoriteti Kontraktues ka pozicionuar dhe ka formuluar kërkesën për **ISO 27001** në dosjen e tenderit përbën një **gabim material dhe ligjor**, me pasojë të drejtpërdrejta në drejtësinë dhe ligjshmërinë e procedurës së prokurimit.

Ky gabim:

- **Cenon konkurrencën e barabartë**, duke vendosur kufizime të panevojshme dhe të pajustificuara që pengojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që kanë kapacitete reale për përmbushjen e kontratës.
- **Shkel parimin e proporcionalitetit**, duke vendosur kërkesa që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshme me objektin e kontratës.
- **Përzien kriteret e kapaciteteve teknike/profesionale me përshtatshmërinë profesionale**, në kundërshtim me ndarjen e qartë të përcaktuar në LPP dhe RRUOPP.

· **Keqinterpreton nenin 26.6 të RRUOPP dhe nenin 70 të LPP-së**, duke e trajtuar gabimisht ISO 27001 si certifikatë për sigurimin e cilësisë, kur ky standard nuk përbën të tillë në kuptimin e ligjit.

Për këtë arsye, në përputhje me ligjin dhe për të garantuar një procedurë të drejtë dhe konkurruese, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- Të rishikojë dokumentet e tenderit në përputhje me ligjin;
- Të largojë kërkesën për **ISO 27001 nga Kërkesat e Përshtatshmërisë**

Profesional;

Të ripërcaktojë, nëse kjo kërkesë mbetet e arsyeshme për objektin e kontratës, si **kërkesë mbi kapacitetet teknike dhe profesionale**, duke lejuar përmbushjen e saj nga grupi si tërësi dhe jo domosdoshmërisht nga secili anëtar individual.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e supozuar nga Autoriteti Kontraktues, përmes vendosjes së gabuar të kërkesës për ISO 27001 në Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale, ka shkaktuar dhe kërcënon të na shkaktojë dëme materiale të drejtpërdrejta, pasi kufizon padrejtësisht mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në procedurën e prokurimit, pavarësisht kapaciteteve reale teknike dhe profesionale që posedojmë për realizimin e kontratës. Kjo kërkesë e panevojshme dhe disproporcionale krijon kosto të pajustificuara për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, si dhe rrezik të drejtpërdrejtë të përjashtimit tonë nga gara në mënyrë të paligjshme, duke na privuar nga mundësia për të fituar kontratën dhe për të realizuar përfitimet materiale që do të rridhnin nga ekzekutimi i saj.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të derguar nga "Global CT Digital Kosovo" në procedurën e tenderit për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e aplikacionit që përmban të dhëna shëndetësore të pacientëve dhe mund të konstatojmë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara.

Autoriteti Kontraktues (AK) konsideron se kërkesa për certifikatën ISO 27001 nuk shkel ligjin për Prokurimin Publik (LPP) apo Rregulloren për Prokurimin Publik (RRUOPP). Përkundrazi, ajo është bazuar në parimet ligjore dhe nevojshëm për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave të ndjeshme shëndetësore. Në këtë analizë adresohen veçmas pretendimet për shkelje të neneve 6, 7, 66, 69, 70 të LPP-së dhe nenit 26.6 të RRUOPP-së, duke u bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, kuadrin e mbrojtjes së të dhënave në Kosovë, standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Në përfundim provohet se vendosja e kërkesës ISO 27001 është ligjore, proporcionale dhe e domosdoshme për projektin në fjalë.

• **Lejueshmëria sipas LPP neni 70 dhe RRUOPP neni 26.6.** Neni 70 i LPP-së lejon qartë autoritetin kontraktues të kërkojë dorëzimin e certifikatave nga autoritetet pavarura që vërtetojnë përputhshmërinë me standarde sigurie të caktuara. RRUOPP 26.6 sqaron se në rast kërkesë të tillë, certifikatat duhet të bazohen në standarde vendore, evropiane ose ndërkombëtare dhe janë pikërisht për vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit me këto standarde. ISO 27001 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Kështu, kërkesa e AK për certifikatën ISO 27001 përmbush këto kushte ligjore dhe pranohet ligjërisht si mekanizëm për sigurimin e cilësisë së shërbimeve të IT-së.

Madje, udhëzuesi operativ për prokurimin shtetëror lejon që specifikimet teknike të përfshijnë standarde ISO për sigurimin e cilësisë. Kjo do të thotë se AK ka bazë ligjore të fortë për të kërkuar certifikatë ISO 27001 dhe kërkesa nuk bie ndesh as me nenin 70 LPP e as me RRUOPP 26.6; përkundrazi, ajo zbatohet në mënyrë të drejtë e transparente.

- **Mbrojtja e të dhënave shëndetësore – ligjshmëria dhe proporcionaliteti.** Të dhënat shëndetësore të pacientëve trajtohen nga ligji kosovar i mbrojtjes së të dhënave personale si kategori e veçantë e dhënash "të ndjeshme" (p.sh., 'gjendja shëndetësore' përmendet eksplicit në ligj). Ky ligj (i harmonizuar me Rregulloren (BE) 2016/679 – GDPR) kërkon që të dhënat personale trajtohen me masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e tyre. Në këtë kontekst, certifikata ISO 27001 është një dëshmi ndërkombëtare e një Sistemi Menaxhimi të Sigurisë së Informacionit (ISMS) që bazohet në praktikatat më të mira globale për mbrojtjen e informacionit. Standarde të tilla i kërkojnë organizatës të identifikojë në mënyrë proaktive dhe të minimizojë rreziqet e sigurisë së informacionit, duke e vendosur në zbatim gjithëpërfshirës politikat e sigurisë së nevojshme. Në veçanti, ISO 27001 shtyn implementimin e masave për të parandaluar humbjen ose aksesin e paautorizuar në të dhënat kritike. Këto kërkesa janë proporcionalisht të justifikuara në projektin në fjalë, sepse përpunimi i të dhënave mjekësore të pacientëve kërkon siguri maksimale. Vetë praktikatat ndërkombëtare e vlerësojnë ISO 27001 si standardin e përshtatshëm pikërisht në sektorë ku ruajtja e të dhënave kritike (p.sh. bankar, financiar, mjekësor etj.) është thelbësore. Kështu, kërkesa për ISO 27001 është e domosdoshme për të garantuar që të dhënat e ndjeshme të trajtohen me standarde të provuara ndërkombëtare dhe përputhet me kërkesën ligjore për masa konkrete sigurie.

- **Parimet e Prokurimit Publik (LPP 6 dhe 7).** Sipas nenit 6 LPP, AK ka përgjegjësi të përdorë fonde publike në mënyrën më ekonomike dhe efikase. Investimi në mbrojtjen e informacionit është pjesë e këtij parimi: kostoja e kërkesës ISO 27001, krahasuar me dëmët e mundshme financiare dhe reputacionale nga shkeljet e sigurisë së të dhënave, është e përballueshme dhe parandaluese ndaj shpenzimeve eventuale. Prandaj kjo marrëveshje e sigurisë përmirëson efikasitetin e përgjithshëm të prokurimit. Parimi i barazisë së trajtimit (neni 7 LPP) ndalon përcaktimin e kushteve që favorizojnë ose diskriminojnë operatorë të caktuar. Kërkesa për ISO 27001 nuk favorizon asnjë operator në veçanti, sepse standardi është i hapur dhe i aksesueshëm për të gjithë. Përkundrazi, duke përdorur standarde ndërkombëtare të njohura, AK vepron me transparencë. RRUOPP 19.3 thekson se specifikimet teknike mund të bazohen në standarde të njohura (p.sh. ISO) për ushtrimin e aktivitetit. Kjo siguron që kërkesa për ISO 27001 nuk krijon barriera të paarsyeshme ndaj konkurrencës, por përkundrazi është një kriter objektiv dhe proporcional që synon të garantojë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve të tenderit. Në përmbledhje, ashtu siç parashikon LPP 7(3), nuk ka qëllim diskriminimi; vendosja e kërkesës ISO është legjitime dhe e paanshme.

- **Kriteret profesionale dhe teknike (LPP 66 dhe 69).** Neni 66 LPP lejon kërkimin e licencave profesionale të nevojshme, por kjo lidhet me autorizimet ligjore (p.sh. licenca doktorimi, inxhinierie, etj.) që duhet në vendet e origjinës. Kërkesa ISO 27001 nuk ka të bëjë me licencim profesional, por me certifikim cilësor. Pra pretendimi se shkel 66-ën nuk mbështetet në vendimtar, pasi ISO nuk është licencë profesionale. Për sa i përket nenit 69 LPP (aftësia teknike/profesionale), ai sanksionon se AK mund të kërkojë prova konkrete të kualifikimeve teknike të nevojshme. Certifikata ISO 27001 është pikërisht një dëshmi e aftësisë teknike të operatorit për të mbajtur standarde të larta sigurie në përpunimin e informacionit. Në mungesë të kësaj certifikate, prova të tjera të barazvlershme (raporte auditimi etj.) janë të lejuara nga ligji, por ISO 27001 ofron një nivel sigurie më të lartë dhe të njohur ndërkombëtarisht, prandaj AK e ka zgjedhur si kërkesë minimale teknike. Kështu, sipas nenit 69, AK ka të drejtë të kërkojë forma të tilla të verifikimit të kapaciteteve teknike; kjo nuk shkel asnjë rregull, përkundrazi plotëson qëllimin e ligjit për të siguruar kontraktorë me kapacitete të vërtetuara teknike.

- **Arsyeshmeria e kërkesës.** Kërkesa për certifikatë ISO 27001 bazohet në parimin e masave proporcionale e të nevojshme: përpunimi i të dhënave të ndjeshme shëndetësore parasheh rreziqe të larta dhe kërkon standarde të rrepta sigurie. Kjo është përputhur me kërkesat ligjore për mbrojtjen e privatësisë dhe me praktikatat më të mira ndërkombëtare (p.sh. rregulloret e NIS, rekomandimet e institucioneve shëndetësore, etj.), të cilat theksojnë rëndësinë e përdorimit të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001 në mjedise të tilla. Në terma të prokurimit, siç u citua, standardet e këtij lloji janë parashikuar qartë nga legjislacioni vendor (LPP 70, RRUOPP 19.3, 26.6) si pjesë integrale e specifikimeve teknike. Prandaj, kundërshtimet e operatorit se kërkesa është e tepruar ose e paarsyeshme nuk qëndrojnë. Përkundrazi, vendosja e kësaj kërkesë demonstroi kujdesin maksimal të AK për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e projektit, dhe do të minimizojë rreziqet për shkeljen e sigurisë së të dhënave të pacientëve, që është në funksion të ruajtjes së interesit publik dhe eficiencës së prokurimit.

Përfundim

Në përfundim, Autoriteti Kontraktues konkludon se kërkesa për certifikatën ISO 27001 është e ligjshme, proporcionale, e nevojshme dhe e justifikuar për shkaqet e mësipërme. Ajo zbatohet në përputhje me parimet e LPP-së (efikasitet-in, trajtim të barabartë) dhe parashikon një standard ndërkombëtar të provuar për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm shëndetësor. Pretendimet e Global CT Digital Kosovo se kjo kërkesë shkel nenet 6, 7, 66, 69, 70 LPP dhe nenin 26.6 RRUOPP konsiderohen të pabazuara. Në çdo rast, kërkesa lidhet ngushtë me objektivin thelbësor të sigurimit të shëndetit dhe privatësisë së pacientëve në përdorimin e aplikacionit të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të gjitha këto arsye, AK mbron vendimin e tij dhe konfirmon se kërkesa për certifikatën ISO 27001 do të mbetet pjesë e kriterëve kualifikuese të tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit